



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 12, datë 28.01.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E LISTËS SË NËNTË TË 6 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO**  
**TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE**  
**INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS**  
**PROJEKTIT MODEL**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm ngritur me urdhër të titullarit të institucionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së nëntë të 6 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas

projektit model, pasqyruar në aneksin I bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtoria Ekonomike si dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 31.01.2022**

ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT

NR	ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R1	TURI	QANI	JASINI	4	2+1	2,617,558
2	R4	ALEKSANDER	VANGJEL	LLUKA	4	2+1	2,617,558
3	SUKTH	SURE	ISMAIL	ALLAMANI	3	2+1	2,617,558
4	MANEZ	PULLUMB	FERHAT	HOXHA	6	3+1	3,428,958
5	ISHEM	VALER	HASAN	XHERAHU	5	3+1	3,428,958
6	ISHEM	FLORIAN	PETRIT	MERDITA	3	2+1	2,617,558





08.02.22 258/11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 92 / prot.  
6

Durrës, më 07.02.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.12 datë 28.01.2022: “Për miratimin e listës së nëntë të 6 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërihë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

